



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETARI

Nr. 5648 Prot

Shkodër, më 17.4.2020

VENDIM

Nr. 94, datë 17.4.2020

**PËR MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES SË FONDIT TË ZËRAVE TË
PROJEKTEVE TË INVESTIMEVE BRENDA TË NJËJTIT PROGRAM PËR VËTIN
2020.**

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar ; të nenit 45 të Ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar; Ligjit nr. 88, datë 18.12.2019 "Per buxhetin e vitit 2020", nenit 100, të udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", udhëzimit plotësues nr. 2 datë 20.01.2020 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020", VKB nr. 26 datë 30.12.2019 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesem perfundimtar 2020 - 2022 të Bashkisë së Shkodrës", si dhe relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Mjedist, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave me nr 1088/6 prot, datë. 08 /04/2020

VENDOSA

1. Miratimin e rishpërndarjes së fondit të zërave të projekteve të Investimeve brenda programit 4260, Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave , nga zëri i shpenzimeve kapitale të trupëzuara (Art.231), tek zëri i shpenzimeve kapitale të patrupëzuara Art.(230), Drejtoria e e Mjedist, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

Pakësim 2020:

Nr	Programi	Emërtimi	Artikulli 231 Shpenzime kapitale të trupëzuara
1	04260 (5)	P04260.O3.A1 Investime për përmirësim të fondit pyjor/kullosor A.1 . Investime për përmirësim të fondit pyjor/kullosor	4, 743,000 lekë
		Totali	4, 743,000 lekë

Shtesë 2020:

Nr	Programi	Emërtimi	Artikulli 230 Shpenzime kapitale të patrupëzuara
1	04260 (5)	P04260.O3.A1 Investime për përmirësim të fondit pyjor/kullosor. A.2 Hartimi i planit të mbarështimit të Pyjeve e Kullotave (PMPK), Ekonomia Pyjore Bruçaj.	4, 743,000 lekë
		Totali	4, 743,000 lekë

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë Shkodër.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR



Zv/Kryetar

[Handwritten signature]

Zv/Kryetar

[Handwritten signature]

Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të
Ujrave

Adela Sullku

Drejtoria e Analizës dhe
e Programimit Buxhetor

Arben Hoxha

Arben Hoxha

Drejtoria Juridike

Zulvan Daj

Drejtoria e Financës

Blerta Breda